



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.1081/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Milena Đerić Kryesuese, Rrustem Thaqi dhe Faton Ademi, duke vendosur përkitazi me apelin e kandidates për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Deçanit, Violeta Rukalaj nga Subjekti Politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, me seli në Prishtinë, dega në Deçan paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur më datë 07.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. Pranohet pjesërisht si i bazuar apeli Anr.1081/2021 i datës 04.11.2021, i kandidates për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Deçanit, Violeta Rukalaj nga Subjekti Politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal.

II. Urdhërohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) që të rinumëroj vetëm fletëvotimet për Kandidat për Kuvend Komunal nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, në Komunën e Deçanit, në Vendvotimin VV 0103C/01R, BM 101/001, BM 101/002, BM201/001, BM201/002, BM201/003.

III. Rezultati i cili del pas rinumërimit të fletëvotimeve në kutitë në Vendvotimin si në pikën -II- të këtij dispozitivi, të përfshihen në rezultatin përfundimtar.

IV. Refuzohet e pabazuar pjesa e apelit e paraqitur nga kandidatja për anëtare të Kuvendit Komunal në Deçan Violeta Rukalaj nga Subjekti Politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal me të cilën ka kërkuar rinumërimit e votave në vendvotimet VV 0103C/02R dhe VV 0102C/02R, me të cilën ka kërkuar rinumërim të votave për këto vendvotime.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një apel me datën 04.11.2021 nga kandidatja për anëtare të Kuvendit Komunal në Deçan, Violeta Rukalaj nga Subjekti Politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës në të cilën pretendon se në vendvotimet VV 0103C/01R ka zero vota edhe pse ka dëshmitar se në këtë vendvotim ka votuar për kandidatin në fjalë, në vendvotimet e destinuar për votat me postë si BM101/001, BM 101/002, BM201/001, BM201/002, BM201/003 nuk gjenden votat e saj edhe pse votues të saj kanë deklaruar se kanë votuar me postë nga shteti i Francës dhe Gjermanisë mirëpo votat nuk i janë numëruar dhe i mungojnë. Në vendvotimet VV 0103C/02R dhe VV 0102C/02R thekson se e kanë votuar dy votues mirëpo votat e tij mungojnë. Prandaj përmes apelit ka kërkuar që të bëhet rinumërimi i votave në Vendvotimet e theksuara si në apel. Krahas apelit si dëshmi ka bashkangjitur deklaratat e katër dëshmitarëve si dhe kopje me ermin e listës së votuesve jashtë vendit.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, vlerësimit të provave të bashkangjitura dhe sipas hetimit të kryera nga vet PZAP, në ankesë në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është pjesërisht i bazuar.

Nga shkresat e lëndës, rezulton se kandidatja për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Deçanit, Violeta Rukalaj nga Subjekti Politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, ka parashtruar apel ku ka kërkuar nga PZAP-i, që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve në VV 0103C/01R, BM101/001, BM 101/002, BM201/001, BM201/002, BM201/, VV 0103C/02R dhe VV 0102C/02R në Komunën e Deçanit sa i përket numrit të votave për kandidat.

Paneli vlerëson se apeli është pjesërisht i bazuar sa i përket Vendvotimit të vendosur si në pikën -II- të dispozitivit të këtij vendimi, nga se rezulton se nga verifikimi i të dhënave zyrtare të ofruara nga KQZ rezulton se në vendvotimin VV 0103C/01R, rezulton të ketë zero vota derisa ka një deklaratë se në këtë vendvotim është votuar për kandidatin në fjalë. Po ashtu pas verifikimeve të bëra për kandidaten në fjalë për votat e adresuara me postë për të njëjtën rezultojnë të jenë zero vota, derisa ka të bashkangjitur listën e votuesve jashtë vendit me emrat të cilët e kanë votuar si dhe faturën e pagesës, andaj PZAP nga këto arsye, dhe në mbështetje të nenit 117.4 të LZP-së e urdhëron KQZ-në që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve për qendrat e votimit e si në pikën II të dispozitivit të këtij vendimi.

Paneli, vlerëson se ky rinumërim e bënë procesin e numërimit të fletëvotimeve dhe shpalljen e rezultateve të saktë në kuptim të nenit 101 paragrafi 1 i LZP-së, me të cilin përcaktohet se: *“Procedura e numërimit të fletëvotimeve qeverisen nga objektivat e mëposhtme: saktësia, transparencia, efikasiteti, mundësia për rinumërim dhe përsëritja e zgjedhjeve dhe mbrojtja e fshehtësisë së votës”*. Nga kjo rezulton se mos procedimi i fletëvotimeve sipas dispozitës së lartë cituar, përveç cenimit të saktësisë, transparencës dhe kredibilitetit, po ashtu cenon integritetin e procesit zgjedhor dhe se pa evitimin e kësaj parregullsie, përmes rinumërimit, ky integritet dhe kredibilitet do të vihet në pikëpyetje. Për çka mbi bazën e të lartë cekurave Paneli, ka vendosur si në pikën -I- dhe -II- të dispozitivit të këtij vendimi.

Andaj PZAP nga këto arsye, dhe në mbështetje të nenit 117.4 urdhëron që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve për vendvotimin e lartcekur, si në pikën II të dispozitivit.

Ndërsa sa i përket pjesës refuzues, të vendosur si në pikën -IV-, të dispozitivit paneli, vlerëson se parashtruesja e apelit në mbështetje të pretendimeve të saj, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara për mospërputhje të rezultateve, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret paneli në vendvotimin e pretenduar VV 0103C/02R për të cilin ka bashkangjitur deklaratë si dëshmi se e kanë votuar dhe nuk ka pasur vota, për të njëjtin pas verifikimeve të bëra nga të dhënat zyrtare të ofruara nga KQZ, rezultojnë të jenë gjithsej 4 vota në këtë vendvotim. Po ashtu edhe për vendvotimin VV 0102C/02R për të cilin ka pretenduar i mungojnë votat dhe ka bashkangjitur një deklaratë si dëshmi, pas verifikimeve rezulton se kandidati në fjalë ka gjithsej 6 vota.

Andaj edhe Paneli nuk mundi të konstatoj se ka pasur manipulime gjatë numërimit të votave për kandidat të këtij subjekti politik, ashtu siç pretendon ankuesja, për faktin se thëniet e saj nuk mbështetën në asnjë provë konkrete, pretendimet e saj mbeten vetëm në suaza të dyshimeve. Pritjet e ankuses për të marrë më shumë vota automatikisht nuk nënkupton se ka mospërputhje të rezultatit si dhe llogaritja matematikore nga ana e ankuesit nuk argumenton shkeljet e pretenduara në apel.

Prandaj më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura dhe bazuar në nenet 115.1, dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze* po ashtu lidhur me nenin 118 paragrafi 1 dhe 120 par. Pika d) të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.1081/2021 më datën 07.11.2021

Kryesuese e Panelit

Milena Đukić



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.